



Mbrojtje inovative e bimëve, studentët praktikë kontrolli në serrën me domate

Faqe 6



Mbështetja nga IPARD, ferma me mandarina në Konispol, furnizon tregun vendas dhe të huaj

Faqe 6



La infermierinë, për t'u bë kasape: Nuk jam penduar, doja të kisha punën time

Faqe 6



# AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,  
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KESHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit nëntor 2023

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 474  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

# SECO DHE UNIDO MBËSHTESIN SHQIPËRINË NË PROGRAMIN GLOBAL FORUMI I 1-RË KOMBËTAR PËR CILËSINË DHE STANDARDET, PLATFORMË INOVATIVE QË INKURAJON DIALOGUN DHE BASHKËPUNIMIN NË SEKTORIN E BUJQËSISË DHE EKSPORTEVE

*Në Forumin e Parë Kombëtar Për Cilësi dhe Standarde u diskutua mbi nevojën në rritje për përputhjen me standardet ndërkombëtare në produktet bujqësore dhe ushqimore shqiptare si një bazë e fortë për zhvillim dhe tregti*

## RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

**Zyrat e karrierës në UT, RisiAlbania mbështetje për rritjen e kapacitetit profesional**

*Studentët e Universitetit të Tiranës, me shërbim të ri nga zyra e Karrierës, që i ndihmon ata për të njohur sa më mirë veten*



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



**Takimi në Bruksel për kapitullin "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural", Denaj: Përparim në përafrimin e kuadrit ligjor**



Faqe 2

## IN MEMORIAM



**Ndahet nga jeta Z. Shkëlqim Agolli, një nga statisticienët më të mirë të Shqipërisë, që dha kontribut të çmuar në evidentimin e rolit të rëndësishëm të Bujqësisë në ekonominë kombëtare të vendit tonë**

Faqe 4

## TEMA TË DITËS

- Qeveria: Pagë të diferencuar për agronomët dhe veterinerët Fq.4
- Çelet Java e Sipërmarrjes, promovon inovacionin e fuqizon komunitetin e biznesit shqiptar Fq.5
- OKB paralajmëron: Bota po humbet 1 milion km<sup>2</sup> tokë produktive në vit nga stuhitë e rërës dhe pluhurit Fq.5
- Kalendari bujqësor, muaji dhjetor 2023 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

## DONATORËT

**Qeveria zvicerane do të vlerësojë pjesën e lëndëve të para në PBB-në e vendit**

Faqe 6

## PAKETË FISKALE

**Nga 1 janari zero TVSH në import për bletët dhe insektet që zëvendësojnë pesticidet**



Faqe 2

RISI ALBANIA

INTEGRIMI NË BE

# Zyrat e karrierës në UT, RisiAlbania mbështetje për rritjen e kapacitetit profesional

*Studentët e Universitetit të Tiranës, me shërbim të ri nga zyra e Karrierës, që i ndihmon ata për të njohur sa më mirë veten*

Përfundoi trajnimi i zyrave të Këshillimit të Karrierës të Universitetit të Tiranës mbi “Testet e Karrierës”. “Testet e Karrierës” ose “Testet e Aftësisë për punë” janë teste ndërkombëtare dhe të standardizuara sipas nevojave të kontekstit shqiptar nga hulumtuese të Qendrës së Karrierës në Fakultetin e Shkencave Sociale, UT, në bashkëpunim me Universitetin e Lozanës në Zvicër. Ato matin interesat, vlerat, personalitetin dhe aftësitë e ndërsjella të studentit


drejt orientimit në karrierë.

Përfaqësues të zyrës së Këshillimit të Karrierës në Universitetin e Tiranës, u shprehën: “Fakulteti ynë pati përfaqësinë e tij në këtë trajnim dhe tashmë studentët do të kenë një shërbim të ri nga zyra e Karrierës, që do t’i ndihmojë ata për të njohur sa më mirë veten”.

Katër ishin testet e standardizuara me të cilat u trajnuan këshilluesit e Karrierës së të gjitha Fakulteteve: ADOR - Analiza e kërkesës për ori-

entim, CDDQ - Vështirësitë në Procesin e Vendimmarrjes për Karrierën, PGI - Inventari i matjes së interesave ose shkurt (Personal Globe Inventory) dhe VISA -Vlerësimi i Statusit të Identitetit Profesional.

Trajnimi zgjati 8 ditë dhe kjo u bë e mundur falë mbështetjes që projekti RisiAlbania ofron për rritjen e kapacitetit profesional të stafit të zyrave të karrierës pranë Universitetit të Tiranës dhe zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në UT.



**Katër ishin testet e standardizuara me të cilat u trajnuan këshilluesit e Karrierës së të gjitha Fakulteteve: ADOR - Analiza e Kërkesës për Orientim, CDDQ - Vështirësitë në Procesin e Vendimmarrjes për Karrierën, PGI - Inventari i Matjes së Interesave ose shkurt (Personal Globe Inventory) dhe VISA -Vlerësimi i Statusit të Identitetit Profesional.**


# Pr/buxheti 2024, Mete: 234 milionë lekë për arsimin profesional

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Ervin Mete u shpreh se në projektbuxhetin e vitit 2024 janë parashikuar 234 milionë lekë për arsimin profesional.

Ndërsa ndau të dhënat për këtë zë të projektbuxhetit, Mete theksoi se arsimi profesional vijon të jetë në fokus të politikave të qeverisë.

Sipas tij, janë 11.500 persona që do të përfitojnë nga kurset e formimit profesional, nga fondi i parashikuar për vitin 2024.

Arsimi profesional konsiderohet si rruga e sigurt drejt punësimit real, ndaj dhe qever-



ia shqiptare po mbështet me politika të veçanta kualifikimin e fuqisë punëtore në përputhje me nevojat e tregut të punës.

# Takimi në Bruksel për kapitullin “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”, Denaj: Përparim në përafrimin e kuadrit ligjor

Në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, u zhvillua në Bruksel takimi dypalësh për Kapitullin 11

axhendës evropiane për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, u shpreh Denaj.

Në këtë takim të rëndësishëm me ekspertët e Komisionit Evropian, delegacioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i kryesuar nga zv/ministri Arian Jaupllari, prezantoi progresin e bërë dhe sfidat në përafrimin e agjendës evropiane për bujqësinë dhe zhvillimin rural, ku ekspertët e KE-së, theksuan rëndësinë e këtij kapitulli, nisur nga vëllimi i legjislacionit dhe i buxhetit të dedikuar për të dhe nga struktura administrative që duhet të ketë për zbatimin e tij.



“Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”, pjesë e Klasterit 5: Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj falënderoi të gjithë ekipin e MBZHR-së, që udhëhoqën delegacionin në kuadër të raportimit të procesit Screening në Bruksel, ku u zhvilluan me sukses takimet 3-ditore me ekspertët e Komisionit Evropian për Kapitullin 11 “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”.

“Jemi krenarë që Shqipëria po përparon me përafrimin e kuadrit ligjor, në fokus të

delegacioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i kryesuar nga zv/ministri Arian Jaupllari, prezantoi progresin e bërë dhe sfidat në përafrimin e agjendës evropiane për bujqësinë dhe zhvillimin rural, ku ekspertët e KE-së, theksuan rëndësinë e këtij kapitulli, nisur nga vëllimi i legjislacionit dhe i buxhetit të dedikuar për të dhe nga struktura administrative që duhet të ketë për zbatimin e tij.

Takimi u fokusua në shpjegimin e legjislacionit të përafëruar me politikën koher-

ente të Politikave të Përbashkëta Evropiane CAP, dokumentat strategjikë për këtë fushë, skemat mbështetëse kombëtare, menaxhimi financiar/ monitorimi i shpenzimeve, sistemet e IACS, FADN, pagesat direkte për fermerët, rezultatet e përgjithshme të zbatimit të Programit IPARD II, përgatitjet për programin IPARD III, mekanizmat e tregut, përafrimi i legjislacionit me acquis-në e BE-së për produktet e ndryshme bujqësore dhe blegtorale si mish, qumështi, vezët, mjalti, vaji i ullirit, drithërat, frutat, perimet, etj.

Në ditën e fundit të takimit përfaqësuesit e MBZHR-së prezantuan arritjen në fushën e verës, prodhimin organik, politikën e cilësisë, promovimin e produkteve organike si dhe politikën e qeverisë për luftën kundër korrupsionit në këtë fushë.

Ekspertët e Komisionit Evropian falënderuan për prezantimet e bëra dhe për pyetësorin e dorëzuar në kohë, duke vlerësuar dhe sfidat që përfaqëson ky kapitull dhe inkurajoi Shqipërinë të vazhdojë intensivisht me punën e nisur duke konsideruar dhe mbështetjen e palës evropiane, pasi fusha e bujqësisë është një pjesë themelore e kësaj qasjeje të përbashkët.



# Nga 1 janari zero TVSH në import për bletët dhe insektet që zëvendësojnë pesticidet

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj bëri të ditur se nga janari i vitit që vjen përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar në import kafshët e racës së pastër për riprodhim, bletët dhe insektet që zëvendësojnë pesticidet.

Ndryshimet në ligjin “Për TVSH” janë pjesë e Paketës Fiskale 2024.

“Me ndryshimet në ligjin “Për TVSH”, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar në import kafshët e racës së pastër për riprodhim, bletët dhe insektet që zëvendësojnë pesti-

cidet. Këto lehtësi ndihmojnë sektorin e prodhimit me rritjen e numrit të krerëve në blegtori dhe nxitjen e prodhimit blegtoral, zhvillimin e sektorit të bletarisë, stimulimin e prodhimit organik dhe luftës me metoda organike në bujqësi, përdorimin e metodave inovative në bujqësi për kontrollin biologjik të insekteve të dëmshme”, deklaroi ministrja Denaj.



## CILËSI DHE STANDARDE

## SECO DHE UNIDO MBËSHTESIN SHQIPËRINË NË PROGRAMIN GLOBAL

# FORUMI I 1-RË KOMBËTAR PËR CILËSINË DHE STANDARDET, PLATFORMË INOVATIVE QË INKURAJON DIALOGUN DHE BASHKËPUNIMIN NË SEKTORIN E BUJQËSISË DHE EKSPORTEVE

*Në Forumin e Parë Kombëtar Për Cilësi dhe Standarde u diskutua mbi nevojën në rritje për përputhjen me standardet ndërkombëtare në produktet bujqësore dhe ushqimore shqiptare si një bazë e fortë për zhvillim dhe tregti*

Në nëntor të vitit 2023, Tirana u bë vendi i zhvillimit të një ngjarje të rëndësishme që ndriçoi sfidat dhe potencialet e sektorit bujqësor dhe ushqimor. Forumi i Parë Kombëtar për Cilësi dhe Standarde, një iniciativë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të bashkëpunim me Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), me mbështetjen dhe financimin e Sekretariatit Shtetëror Zvicëran për Çështjet Ekonomike (SECO), vuri në dukje rëndësinë e përputhjes me standardet ndërkombëtare duke theksuar gjithashtu rolin e digjitalizimit dhe inovacionit. Kështu, ky forum nuk theksoi vetëm nevojën për përshatjen në nivel global, por gjithashtu shënoi rolin e teknologjisë dhe inovacionit në avancimin e sektorit.

në sektorin bujqësor dhe rritje e shkallës së prodhimit përmes bashkimit të operatorëve.



Znj. Dorina Nati, në fjalimin e saj, theksoi se harmonizimi dhe investimet në infrastrukturën e cilësisë do të ndihmojnë vendin të përmbushë më mirë standardet ndërkombëtare dhe europiane. Ky proces i harmo-

dhe bashkimi i operatorëve janë faktorë kyç për të arritur objektivin ambicioz të 1 miliard USD eksport shqiptar në vitin 2030. Për më tepër, në kontekstin e një transformimi të thellë ekonomik në Shqipëri, ku rritja në sektorin bujqësor dhe tur-



izmi po shënjonë ndryshime të ndjeshme, Ministria Denaj theksoi se ndërmarrjet shqiptare

bujqësisë, duke nxitur një angazhim të përbashkët për të përmirësuar dhe avancuar këtë sektor në dobi të ekonomisë dhe mirëqenies së popullatës.

Në kohën kur kërkesa e tregut dhe pritshmëritë e konsumatorëve për cilësi të lartë

të sektorit bujqësor.

Besimi i pjesëmarrësve se digjitalizimi mund të sjellë një transformim pozitiv u theksua si një mjet për të përmirësuar monitorimin, menaxhimin dhe performancën e prodhimit bujqësor. Diskutimet e thelluara rreth këtyre temave shpërfaqën nevojën për një angazhim të përbashkët të autoriteteve vendore, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare për të siguruar se investimet në teknologji dhe inovacion do të përdoren me efikasitet për të përmirësuar sektorin bujqësor dhe cilësinë e produkteve bujqësore në Shqipëri. Pjesëmarrësit inkurajuan bashkëpunimin

hapa të rëndësishëm drejt një agrobiznesi më të avancuar dhe konkurrues në skenën ndërkombëtare.

Forumu nxitur nga dëshira për të adresuar sfidat dhe shfrytëzuar mundësitë në sektorin bujqësor dhe ushqimor, dha impulsin për një përpjekje të përbashkët për të siguruar që infrastruktura e cilësisë të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Konsensusi i arritur në këtë forum shërben si një bazë e fortë për zhvillimin e sektorit, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt një prodhimi bujqësor dhe ushqimor shqiptar të cilësisë së lartë dhe konkurrues në skenën



Përfaqësuesja e UNIDO, Znj. Dorina Nati, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, Ambasadorja e Zvicrës në Tiranë, Ruth Huber, Përfaqësuesja e OKB-së në Shqipëri, Fiona McCluney, së bashku me ekspertë të fushës, zhvilluan diskutime thelbësore rreth rritjes së cilësisë dhe standardave të produkteve bujqësore në vend. Këto personalitete ndërkombëtare angazhuan një debat konstruktiv, duke theksuar rëndësinë e përmirësimit të cilësisë nëpërmjet përputhjes me standardet ndërkombëtare. Diskutimet e tyre shtruan sfidat me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet bujqësore dhe sektori agro-usqimor në përgjithësi në përmbushjen e kriterëve ndërkombëtare të cilësisë dhe nevojën për një përpjekje të përbashkët në realizimin e standardeve të kërkuara. Ky bashkëpunim ndërkombëtar dhe dialogu mes ekspertëve tregoi se diskutimet thelbësore për cilësinë dhe standardet janë themelore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrues të sektorit bujqësor në Shqipëri. Në këtë forum, u theksua rëndësia e integritit të inovacionit

nizimit do të sjellë jo vetëm një rritje të nivelit të cilësisë, por edhe hapjen e dyerve të reja për eksport, duke hapur rrugën për prodhimet vendore drejt tregjeve ndërkombëtare. Ky fakt, sipas Znj. Nati, do të sjellë vlerë të shtuar për prodhimet vendore, duke kontribuar në rritjen e të ardhurave për fermerët dhe bizneset vendore.

Znj. Anila Denaj, në fjalën e saj theksoi se ky është një hap i rëndësishëm drejt realizimit të objektivit të ambicioz për të arritur 1 miliard dollarë eksport bujqësor në vitin 2030. Kjo vizion i përqendruar drejt eksportit shqiptar është një pjesë e strategjisë së qeverisë për të rritur konkurrueshmërinë dhe stabilitetin afatgjatë të sektorit agro-usqimor. Gjithashtu, Znj. Denaj, në fjalën e saj përmbyllëse, theksoi rëndësinë e cilësisë dhe standardeve të produkteve bujqësore për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit agrousqimor. "Rritja e cilësisë dhe standardit të produkteve bujqësore mbetet thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit agrousqimor," tha ajo. Përmendi gjithashtu se integrimi i inovacionit në bujqësi

duhet të përputhen me standardet ndërkombëtare dhe europiane për të rritur konkurrueshmërinë e tyre.

Forumu Kombëtar për Cilësi dhe Standarde në nëntor të vitit 2023, shënoi një moment të rëndësishëm për sektorin bujqësor dhe ushqimor në Shqipëri. Diskutime të thella u zhvilluan mes përfaqësuesve të autoriteteve vendore, ndërmarrjeve dhe organizatave ndërkombëtare, me fokus kryesor të cilësia dhe standardet në prodhimin agrousqimor. Përputhja me standardet ndërkombëtare u vlerësua si hapi kritik drejt zhvillimit të qëndrueshëm, ndërsa pjesëmarrësit diskutuan për sfidat dhe mundësitë, inkurajuan bashkëpunimin dhe dialogun për zgjidhjen e çështjeve aktuale dhe të ardhshme.

Në këtë kontekst, u theksua se suksesi në tregun europian kërkon një përpjekje të përbashkët të ndërmarrjeve, autoriteteve vendore dhe organizatave ndërkombëtare për të përmirësuar infrastrukturën e cilësisë dhe përmbushur standardet e kërkuara. Forumu u shpall një hap i rëndësishëm drejt promovimit të sektorit të

po rriten, ndërmarrjet shqiptare ndihen të sfiduara dhe të përkushtuara për përputhjen me standardet ndërkombëtare. Forumi Kombëtar për Cilësinë dhe Standarde u shfaq si një platformë e rëndësishme për bashkëpunim dhe dialog, duke inkurajuar të gjitha palët e interesuara të angazhohen aktivisht për të përmirësuar cilësinë dhe standardet në prodhimin bujqësor dhe ushqimor në Shqipëri. Synimi i këtij forumi ishte të krijohet një mjedis ku pjesëmarrësit mund të ndajnë njohuri, përvoja, dhe praktika të mira për të përmbushur dhe tejkaluar standardet ndërkombëtare, duke siguruar një qasje efektive dhe harmonizim në tregun global të produkteve bujqësore shqiptare.

Digjitalizimi dhe inovacioni u rritën si pika kyçe të diskutimit në Forumin Kombëtar për Cilësi dhe Standarde në nëntor të vitit 2023. Pjesëmarrësit e këtij takimi vlerësuan se integrimi i teknologjisë dhe inovacionit në sektorin bujqësor do të çonte në përparime të konsiderueshme në efikasitetin dhe cilësinë e prodhimit bujqësor. Diskutimet u përqendruan në rëndësinë e investimeve në infrastrukturën digjitale dhe trajnimeve për fermerët, vlerësuar si hapa të rëndësishëm drejt modernizimit



dhe koordinimin e përpjekjeve për të siguruar që përfitimet nga digjitalizimi dhe inovacioni të ndihmojnë në krijimin e një sektori bujqësor tërheqës dhe të qëndrueshëm në Shqipëri. Në këtë kontekst, teknologjitë e reja, përfshirë automatizimin, sensorët, dhe aplikacionet e inteligjencës artificiale, shihen si mjetet kyçe për të përmirësuar rendimentin bujqësor dhe për të reduktuar kostot. Në një kohë kur kërkesa e tregut dhe pritshmëritë e konsumatorëve për cilësi të lartë janë në rritje, inovacioni teknologjik bëhet një mjet kryesor për të përmirësuar konkurrueshmërinë e prodhuesve bujqësorë. Përbushja e këtyre teknologjive moderne në praktikën bujqësore do të ndikojë në krijimin e produkteve me cilësi të lartë, duke përgjigjur më mirë nevojave të tregut dhe duke hapur

ndërkombëtare.

Në përfundim, Forumi Kombëtar për Cilësi dhe Standarde #2023 u shndërrua në një arenë të rëndësishme ku autoritetet vendore, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe ndërmarrjet vendore diskutuan dhe arritën një konsensus thelbësor. Diskutimet e thella dhe pjesëmarrja e aktorëve të ndryshëm treguan se sfidat dhe mundësitë e sektorit agro-usqimor janë në qendër të vëmendjes së përbashkët. Konsensusi që u arrit rreth rritjes së cilësisë dhe standardit, si dhe theksimi në inovacion dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare, shënojnë një orientim të qartë për të ardhmen e këtij sektori në Shqipëri. Drejtuesit e politikave, prodhuesit, dhe ndërmarrjet vendore kanë një udhërrëfyes të qartë: për të arritur qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konkurrueshmërisë së sektorit agro-usqimor shqiptar, duhet të vazhdojnë të përqendrohen në rritjen e cilësisë, inovacionin dhe përputhjen me standardet ndërkombëtare në vitet në vijim. Këto përpjekje të përbashkëta do të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi më të përshatshëm për zhvillimin dhe modernizimin e sektorit, duke e nxitur kështu një agrobiznes cilësor dhe të përshatshëm me kërkesat e tregut ndërkombëtar.



## INFORMACIONE

## Investime në bujqësi dhe zhvillim rural, MBZHR: Jemi drejt finalizimit të programit IPARD II

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është drejt finalizimit të programit IPARD 2, i financuar nga BE dhe qeveria shqiptare, për financimin me grante të investime në bujqësi.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, deklaroi se, "programi IPARD 2 një projekt shumë i rëndësishëm për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimin e ekonomisë rurale në vendin është drejt finalizimit".

Gjatë prezantimit të projektbuxhetit të viti 2024, në Komisionin e Financave dhe Ekonomisë, Denaj vuri në dukje ndikim pozitiv që ka dhënë ky program në përmirësimin e ekonomisë bujqësore por dhe të ekonomisë së vendit në tërësi.

"IPARD është një program

i rëndësishëm i mbështetjes së gjithë ekonomisë rurale në vitet e fundit dhe binomit cilës dhe shkallë. Ndërkohë ka nevojë për të përmirësuar disa elementë strukturor në disa institucione që janë përgjegjëse për performacën sidomos me IPARD III dhe ka një procedurë që është duke u rishikuar për që qenë në pozita më të mira për IPARD III", tha Denaj.

Denaj theksoj se zhvil-

limi ekonomik rural në vendin tonë nuk mund të realizohet pa mbështetjen e IPARD dhe i gjithë ky zhvillim që prekim sot duhet të shkoj një hop cilësor më të lartë në IPARD III.

Ministrja informoi se, MBZHR ka është bërë një punë shumë të madhe për 9 masat e mbështetjes nga IPARD III që janë depozituar dhe në këtë proces rishikimi po shihet zbatimimi edhe më mirë.



## Denaj dhe Balla në Fier: Përmirësim i infrastrukturës dhe mbështetje për fermerët

Hartimi i politikave që inkurajojnë një sektor bujqësor më të qëndrueshëm dhe inovativ në qarkun e Fierit ishin në

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, ministri i Brendshëm, Taulant Balla, Prefekti i qarkut Fier si

një takim me të gjithë drejtuesit e institucioneve vendore të MBZHR për të diskutuar mbi problematikat dhe objektivat për qarkun e Fierit.

"U përqendruam në iniciativat për avancimin e sigurisë ushqimore, prodhimit bujqësor, përmirësimin e infrastrukturës rurale dhe mbështetjen e fermerëve në përballje me çështje të ndryshme", u shpreh Denaj.

Ministrja theksoi se duhen bashkuar përpjekjet për të përmirësuar këshillimet bujqësore, mbështetjen e profesioneve si agronomë dhe veterinerë, por dhe për të zhvilluar politika që inkurajojnë një sektor bujqësor më të qëndrueshëm dhe inovativ në qarkun e Fierit.



fokus të një takimi mes autoriteteve qendrore dhe vendore.

dhe deputetë dhe kryetarët e bashkive të qarkut, zhvilluan

## Qeveria: Pagë të diferencuar për agronomët dhe veterinerët

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj zhvilloi një vizitë pranë Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve ku diskutoi me stafin e shërbimit veterinar dhe agronomët, sfidat e arritjet në punën e tyre të përditshme për garantimin e shëndetit publik.

"Trajtua më bashku

propozimin për diferencimin e pagës për profesionet e vështira, agronomët dhe veterinerët, të cilët do të përfitojnë më shumë të ardhura, denjësisht të merituarara për profesionet që ushtrojnë", u shpreh ministrja Denaj.

Ajo bëri të ditur se u kërkoi veterinerëve të kryejnë në kohë të gjithë fushatat e vaksinimit

dhe gjurmimit të tufave blegtorale për të rritur formalizimin e sektorit dhe forcuar standardet e sigurisë ushqimore. Për sa i takon mbrojtjes së bimëve, Denaj tha se synonte të kthente Regjistrin e Fermerit në një platformë digjitale, të njëjtë me platformën tashmë të ndërtuar, Ruda, për regjistrin blegtoral e veterinar.



## IN MEMORIAM

## Ndahet nga jeta Z. Shkëlqim Agolli, një nga statisticienët më të mirë të Shqipërisë, që dha kontribut të çmuar në evidentimin e rolit të rëndësishëm të Bujqësisë në ekonominë kombëtare të vendit tonë

Agolli, eksperti statisticien që e dinte se shifrat nuk e drejtojnë botën, por tregojnë se si mund të drejtohet më mirë ajo



vëlla, mik dhe shok, ashtu siç dinte të ishte ai, si rrallëkush tjetër!

Në ditën e parë të universitetit, njeriun e parë që takova, ishte ai, Shkëlqimi i qeshur, i dashur, i sinqertë, me humor; ai Shkëlqim që të hiqte mërzinë kur ishe i trishtuar, që të jepte kurajo kur ishe i mpakur, që ta dyfishonte gëzimin me praninë e tij në çastet e lumtura. Ai Shkëlqim që kemi njohur gjithnjë!

Ajo e qeshur që njoha 58 vjet më parë, nuk iu nda Shkëlqimit tonë deri në ditën e fundit, kur shpirti i tij fluturoi drejt qiellit. Por edhe qielli do të shkëlqejë nga mirësia, sinqeriteti dhe dashamirësia e të qeshurës së tij, e fjalës së mençur dhe të ngrohtë të Agolliit tonë.

Këto fjalë që më dalin nga shpirti, do t'i thoshte dhe do t'i thotë cilido prej nesh që jemi mbledhur sot, për ta përcjellur për në banesën e fundit. Të gjithë ata që e njohën dhe u rritën bashkë me të rrugicave të Sukthit, në bankat e teknikumit bujqësor të Golemit, në auditorët e Universitetit Bujqësor; në fushat e Manzës, apo në zyrat e rëndësishme të shtetit ku ai punoi, njohën të njëjtin Shkëlqim, pa maskë dhe pa hipokrizi, të dashur si ai, punëtor dhe kurajoz si ai!

Çdo punë që ai bëri, në Komisionin e Planit të Shtetit, në Ministrinë e Bujqësisë, në programet e rëndësishme të financuara nga USAID-i dhe qeveria e SHBA-së, e kreu me profesionalizëm, me disiplinë shkencore, me ndershmëri dhe përkushtim maksimal. Si një nga statisticienët më të mirë të Shqipërisë, ai e dinte se shifrat nuk e drejtojnë botën, por tregojnë se si mund të drejtohet më mirë ajo, prandaj kurrë nuk iu nënshtrua presionit të çfarëdo pushtetari për të shtrembëruar të vërtetën, e cila ishte e shenjtë për Shkëlqimin.

Kur familjarët e Shkëlqimit, më njoftuan për lajmin e trishtë, për vdekjen e njeriut të tyre por jo më pak edhe mikut tone më të shtrenjtë m'u dukën të panevojshme fjalët e rastit, sepse Shkëlqimi do të mbetet përjetësisht i paharruar, për ju dhe për ne, me atë mirësi që e ushqeu gjithë jetën, me atë bukuri të shpirtit që i ndriçoi rrugën e Tij.

Secilit prej nesh do i mungojë kjo pikë takimi dhe miqësie, Çimi ynë i shtrenjtë, i përjetshëm kujtimi yt, i dashur e i paharruar Çimi".

I dashur Çimi! Ti ike nga sytë tanë, por kurrë nga zemrat tona. Mendimet dhe lutjet tona janë me ty. Urojmë, të qoftë i lehtë dheu dhe u prehsh në paqe!

**Lamtumirë, shok, mik, vëlla!  
Lamtumirë!**

Në ceremoninë e lamtumirës, miku i ngushtë i z. Agolli - Namik Dokle ndër të tjera tha:

"Edhe pse gjithë jetën jam marrë me fjalët, sot ato më rëndojnë më shumë se kurrë, në shpirt dhe në zemër, në gjithë kujtimet e viteve, gjatë të cilave pata fatin, ashtu si të gjithë ju, të kem shok e mik njeriun e jashtëzakonshëm, Shkëlqim Agolli. Bashkëshort, prind,



BUJQËSI

GRATË NË SIPËRMARRJE

La infermierinë, për t'u bë kasape: Nuk jam penduar, doja të kisha punën time

Steriotipet i ka lënë mënjanë dhe prej 5 vitesh ushtron zanatin e kasapit. Mirela Hallaçi, ka përfunduar me rezultate mjaft të mira studimet e larta për Infermieri të Përgjithshme, por ka zgjedhur të punojë në biznesin e saj.

me punën e mishit merret bashkëshorti. Çdo gjë që vjen në dyqan, unë e bëj vetë, me prodhim, me qofte, me suxhuk, çdo gjë e bëj vetë. Kam edhe punëtorë, por kam qejf që ta shoh edhe vetë.

punë. E bëj me dëshirë shumë të madhe, kam qejf t'i rri në krahë edhe bashkëshortit. Puna është e rëndë, qëndron në këmbë deri në mbrëmje vonë dhe nuk ka asnjë ditë pushim.



abcnews.ol

Infermieri të Përgjithshme me nota shumë të mira, por për mendimin tim, zanati i infermierisë ka qenë shumë i mirë për mua, por kam pasur qejf që të punoj në punën time më mirë. E nisi si ndihmëse në dyqanin e bashkëshorit dhe sot menaxhon gjithë biznesin.

se punën që bën e dashuron. "Edhe pse nuk e ha fare mishin, është profesion shumë i mirë. E kam trashëgimi nga babai." Fillimet nuk kanë qenë të lehta, madje është ndeshur në habinë dhe paragjykimet e banorëve të Kukësit.

"Për pushime, nuk kam asnjë ditë pushim." Mirela është nënë e 6 fëmijëve dhe në atë pak kohë që i mbetet mundohet t'ju përkushtohet të vegjëlvë. "Është shumë e vështirë, por arrij ta menaxhoj shumë shpejt. Mundohem me sakrificë, me mund që t'ia arrij". Më gjithatë nuk i mungon ndihma e familjarëve të bashkëshortit. Edhe pse lodhja është e përditshme ndaj klientëve, tregohet e kujdeshme duke u mundur t'ju plotësojë çdo kërkesë.

Siguria ushqimore, AKU: 64 inspektime në subjektet e inpleteve bujqësore

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) me një program të posaçëm pune po monitoron në mënyrë të dedikuar subjektet tregtuese të produkteve të mbrojtjes së bimëve (pesticide, fungicide, etj.) dhe vepërimitarinë në sektorin e duhan-cigareve.

me mostrave të marra kanë rezultuar nën normën e lejuar. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit monitoron tregun e për-

për prodhimet që tregtohen në tregun vendas dhe për ato që shkojnë në eksporte. Mbrojtja e shëndetit të kon-



AKU njofton se, gjatë javës 27 tetor - 2 nëntor të këtij viti, ka kryer 64 inspektime në subjektet e inpleteve bujqësore dhe atyre që operojnë në sektorin e duhan-cigareve. Sipas AKU-së, gjatë kësaj jave janë kryer 20 analiza laboratorike dhe janë marrë 18 mostra që janë në proces verifikimi. Ndërkohë inspektorët e AKU-së, kanë vendosur një masë administrative gjorbë me vlerë 200 mijë lekë, për arsye se analizat

dorimit të inpleteve bujqësore, sipas praktikave më të mira europiane, në drejtim të kontrollit që garantojnë standarde të larta të sigurisë ushqimore në vend,

sumatorit është prioritet në punën e këtij institucioni i cili po zgjeron zbatimin e kontrollit ushqimor sipas praktikave europiane.

Mbështetja nga IPARD, ferma me mandarina në Konispol, furnizon tregun vendas dhe të huaj

Incentivat e mbështetjes së qeverisë dhe puna mbresëlënëse e fermerëve në pemëto-

te të zënë një vend të rëndësishëm në tregjet e BE-së. Ervis Pashaj në Konispol,

Ai është mbështetur nga AZHBR, përmes programit IPARD II, për pajisjen e pemëtores me rrjeta antibreshër si edhe zhvillimin e mekanikës bujqësore.



me agrume në skajin jugor të vendit, ka bërë që këto produk-

Sarandë, është një ndër fermerët kultivues të mandarinës në vend.

Me një sipërfaqe prej 1.8 Ha, Ervisi arrin një prodhim prej 150 ton mandarina në vit, destinuar kryesisht për tregun e jashtëm.

Shqipëria është një ndër prodhueset kryesore të agrumeve në rajon, ku prodhimi ka ardhur duke u rritur nga njëri vit në tjetrin.

Sipas të dhënave të fundit nga INSTAT, për vitin 2022 prodhimi arriti në 55.118 ton, ku niveli më i lartë u shënua në qarkun e Vlorës, me 65% të të totalit të prodhimit, dominuar nga mandarina.

Qeveria zvicerane do të vlerësojë pjesën e lëndëve të para në PBB-në e vendit!

Qeveria zvicerane dëshiron të vlerësojë pjesën e tregimit të mallrave në produktin e saj të brendshëm bruto (GDP), pasi vendit aktualisht i mungojnë statistikat për të vlerësuar siç duhet këtë pjesë të ekonomisë së tij.

torit si për politikën e brendshme ashtu edhe për atë të jashtëme," tha qeveria, e cila porositi Zyrën Federale të Statistikave të nisë një mbledhje të të dhënave në qershor 2022. "Ky interes i paraprind agresionit të Rusisë kundër

aktiviteteve të saj në Gjenevë. Sektori përfaqëson rreth 35,000 vende pune në Zvicër, sipas shifrave të publikuara nga Shoqata Zvicerane e Tregtisë dhe Transportit të Mallrave. OJQ-të zvicerane

Në javët pas pushtimit rus të Ukrainës, një nga vështirësitë kryesore të Zvicrës ishte përcaktimi sasior i peshës së sektorit dhe ndikimit të tij ekonomik, kur sanksionet kundër Rusisë po implementoheshin.



"Pavarësisht rëndësisë kombëtare dhe ndërkom-bëtare të tregimit të mallrave në Zvicër, ka pak informacion në dispozicion në këtë fushë", tha Këshilli Federal i Zvicrës në një deklaratë për shtyp.

Ukrainës, por është bërë më i mprehtë që nga fillimi i konfliktit", shtoi ai.

vazhdimisht kritikojnë sektorin për paqartësinë e tij, dëmtrimin mjedisor dhe abuzimet e të drejtave të njeriut.

Zvicra është një nga qendrat kryesore tregtare në botë për lëndët e para. Sipas studimeve të ndryshme, tregtarët zviceranë kontrollojnë një të tretën e tregtisë së naftës së papërpunuar në botë, rreth dy të tretat e tregtisë botërore të metaleve dhe 35% deri në 60% të tregtisë botërore të mallrave bujqësore, sipas njoftimit për shtyp.

Kompani të shumta mallrash me struktura komplekse janë të vendosura në Zvicër. Ndër më të mëdhenjtë është Glencore, e inkuorporuar në Jersey, por me qendër në Baar, në kantonin Zug në Zvicrën qendrore. Gunvor është një tjetër, i regjistruar në Qipro, por me zyrën e tij kryesore tregtare në Gjenevë. Në mënyrë të ngjashme, Traffigura ka selinë në Singapor, por ka një pjesë të madhe të

Këshilli Federal i ka kërkuar Zyrës Federale të Statistikave që të bëjë një analizë të rëndësishme së sektorit, duke zgjeruar të dhënat e tij aktuale për të përfshirë të gjitha aspektet e industrisë, duke marrë parasysh të gjitha kompanitë që punësojnë të paktën tre persona, që përfaqëson rreth 400 kompani. Analiza do të kryhet në 2024, 2025 dhe 2026.

Mbrojtje inovative e bimëve, studentët praktikë kontrolli në serrën me domate

30 studentë të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) patën mundësinë të shikonin nga afër zbatimin praktik të kontrollit biologjik në prodhimin e domates në serra.

së bimëve për të shmangur përdorimin e pesticideve.

ologjik në serra si një teknikë inovatore dhe mbështetje për sektorin e bujqësisë, Ministria e Bujqësisë dhe qeveria ka parashikuar në projekt buxhetin e vitit 2024 heqjen e TVSH për Organizmat e Dobishëm.



Kontrolli biologjik është një metodë inovative e mbrojtjes

Në kuadër të promovimit dhe përhapjes së kontrollit bi-

MBZHR bën të ditur se, tashmë është një rrugë pa kthim në përmirësimin e cilësisë, sigurisë ushqimore dhe shëndetësore për fermerët, tregtarët si edhe konsumatorin. Kontrolli Biologjik është e tashmja dhe e ardhmja për të gjithë prodhimet e perimeve në serra si një metodë inovative duke shmangur përdorimin e pesticideve e duke aplikuar organizmat e dobishëm.

MBZHR së bashku me partnerët privat dhe publik, do të mbështesin fermerët që do të zbatojnë kontrollin biologjik në serra, duke lehtësuar përhapjen e kësaj metode e cila do të revolucionizojë bujqësinë në Shqipëri.

## SIPËRMARRËS TË RINJ

## 2 vëllezër nga Strumi, Roskovec me pasionin dhe punën kanë arritur suksesin në një seri investimesh në serra, pikë grumbullimi dhe fabrikë agro-përpunuese

Dy vëllezër nga Strumi i Roskovecit me ndihmën financiare të qeverisë shqiptare investojnë në serra, pikë grumbullimi dhe fabrikë ambalazhimi dhe përpunimi të fruta perimeve.

Arlind Hazizi 34 vjeç nga fshati strum ka lënë emigrimin në shtetin helen në vitin 2019 dhe është rikthyer në vendlindje duke aplikuar dhe përfitur në skemat ndihmëse për bujqësinë që i mundësuan ndërtimin e një serre moderne me një sipërfaqe prej 1 ha. Ky

është viti i parë i prodhimit në kulturën e domates dhe rendimenti është i kënaqshëm dhe me treg të sigurt vendet e rajonit dhe në europë. Arlindi tregon se ky investim ja ka vlejtur duke dhënë dhe një mesazh për gjithë të rinjtë që me punë dhe përkushtim mund të arrijnë të ndërtojnë të ardhmen në vendin e tyre.

Por kjo sipërmarrje ka nisur më herët me vellanë e tij më të madh Julianin 35 vjeç që ka lënë profesionin e inxhinierit dhe ekonomistit dhe i ka hyrë

para 4 vitesh rrugës së biznesit. Falë dëshirës dhe punës Juliani ka ndërtuar një pikë grumbullimi të produkteve bujqësore, fruta-perime dhe këtë vit ka nisur ndërtimin e një fabrike agro-përpunuese, konservimi dhe ambalazhimi të produkteve të prodhuara nga biznesi familjar dhe të fermerëve të zonës. Për Julianin ky investim ka sjellë përfitime, por nga ana tjetër synon që këto produkte të kenë certifikatën "Made in Albania" duke i standardizuar në nivelin e vendeve europiane.



## Dhia e egër në Alpet e mbuluara nga dëborë

Moratoriumi i gjuetisë në Shqipëri ka bërë që të shtohet numri i dhive të egra në Shqipëri.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ndau në rrjetet sociale momente të filmuara në Parkun Kombëtar "Alpet e Shqipërisë", ku duket dhia e egër në dëborën që ka mbuluar terrenin.

"Dëborë e parë në Parkun Kombëtar "Alpet e Shqipërisë" së bashku me dhinë e egër, vijnjë mrekullisht bukur të dokumentuara", shkruan AKZM.

Dhia e egër ballkanike – (Rupicapra rupicapra) i takon klasës së gjitarëve (Mammalia)

në radhën e çift-thundrakëve (Artiodactyla). Mund të arrijë lartësi deri në 80 cm, dhe gjatësi deri në 130 cm, ndërsa disa meshkuj më të fortë arri-

jnë peshë edhe deri në 40 kg.

Ushqimi i saj përbëhet prej bimëve barishtore, gjethet e reja të shkurreve të larta mallore, manaferrat dhe mjedrat.



## Kuvendi miraton ndryshimet në ligjin për TVSH-në, nxitje zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë

Kuvendi miratoi të hënën në parim me 73 vota, ndryshimet në ligjin "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i cili parashikon përjashtimin nga TVSH për importimin e mëshqerrave, bletëve dhe insekteve.

Përmes këtij ndryshimi, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural synon nxitjen e importit të mëshqerrave dhe insekteve (përfshirë edhe bletët), me qëllim rritjen e numrit të krerëve në vendin tonë, zhvillimin e sektorit të bletarisë,

stimulimin e prodhimit bio, duke eliminuar përdorimin e hormoneve dhe praktikave të zakonshme, si dhe përdorimin e metodave inovative në bujqësi për kontrollin biologjik të insekteve të dëmshme.

Konkretisht ndryshimet në ligjin "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" parashikojnë përjashtimin nga TVSH të mëshqerrave të racës së pastër për riprodhim, që përfshihen në kodin 0102 21 10 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave si

dhe insekteve, të cilat përfshihen në kodet 0106 41 00, 0106 49 00 dhe 0106 90 00 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Kjo masë pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së produkteve dhe përmirësimin e imazhit të produkteve vendase, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Zbatimi i kësaj dispozite parashikohet të sjellë një efekt financiar negativ prej 155 milionë lekësh në buxhetin e shtetit.

## "Në fshat 2", prezantimi i produkteve turistike për katër fshatra

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkë me GIZ Albania përmbyllën me sukses projektin "Në Fshat 2", ku u prezantuan produkte të shumta turistike dhe u certifikuan studentët pjesëmarrës.

Gjatë dy javëve të plota, studentët e "Në fshat 2", të ndarë në 4 skuadra nën udhëheqjen e mentorëve të tyre dhe të shpërndarë në fshatrat e Zogaj, Rabdisht, Boboshticë dhe Nepravishtë, eksploruan, bashkëpunuan

ngushtë me Bashkitë përkatëse si dhe takuan nga afër banorët vendas.

Në këtë eksperiencë unike u ideuan një mori produkte turistike që nxjerrin në pah kulturën apo traditat e çdo fshati, duke patur në fokus zhvillimin përmes një qasjeje sistematike, ku nëpërmjet partneriteteve lokale popullata vendase do të përfitojë ekonomikisht në të ardhmen.

Së shpejti, në bashkëpunim me aktorë të tjerë nis puna për

zbatimin dhe financimin e këtyre produkteve turistike, me qëllim krijimin e modeli të fshatit turistik shqiptar!

Përkushtimi i palodhur i studentëve gjatë këtij projekti u kurorëzua me certifikimin e tyre nga GIZ Albania. Jemi krenarë për përpjekjet e tyre të palodhshme dhe presim me padurim të shohim impaktin pozitiv që këto nisura do të kenë në komunitetet lokale dhe më gjerë në peizazhin e turizmit.



## Parku i bletëve me 126 koshere në Gjirokastrë me mbështetjen e AZHBR-së

Kastriot Nana është një ndër përfituesit masës për mbështetimin e bletarisë, në Skemën Kombëtare të Mbështetjes 2023, në Gjirokastrë.

Ai ka një numër prej 126 kosheresh dhe prej vitesh ushtrojnë familjarisht këtë aktivitet.

Bletaria është një pasion por edhe një punë fitimprurëse, ku për Kastriotin bashkohen më së miri natyra piktoreske e nevojshme për bletët, puna dhe përkushtimi ndaj tyre.

Bletaria është një nga sektorët e rëndësishëm të ekonomisë, e cila ka pasur një zhvillim të konsiderueshëm në vitet e fundit. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) prej vitit 2009 ka mbështetur vazhdimisht këtë sektor përmes Skemës

Kombëtare të Mbështetjes, por edhe programit IPARD.

Mbi 900 fermerë më shumë

kuan dhe u shpallën përfitues nga skema e mbështetjes "Për mbështetimin e bletarisë". Në



se në vitin 2022 aplikuan këtë vit për subvencione direkte në mbështetimin e bletarisë, nëpërmjet Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi.

Janë 3899 fermerë në total në shkallë vendi që kanë apli-

raport me vjet aplikimet për bletarinë janë shtuar 33 %. Për mbështetimin e bletarisë fermerët subvencionohen në vlerën deri në 1000 lekë për zgjuar, për ferma me jo më pak se 50 zgjoje.

## Dita Ndërkombëtare e Ullirit, Denaj nga Vlora: Eksportet u rritën me 43 herë gjatë 10-mujorit

### 26 nëntori dita botërore e Ullirit

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj u takua në Vlorë me fermerë e sipërmarrës që merren me kultivimin e ullirit.

Denaj vuri në dukje se ulla mjetëvjeçarë në vendin tonë, tradita e përpunimit e përmirësuar ndër breza dhe praktikrat mod-

erne bujqësore, sjellin një produkt me cilësi të lartë, që konkurren denjësisht në tregjet elitare të eksportit, duke rritur ekonominë për fermerët shqiptarë.

"Në Vlorë, gjatë takimeve me fermerët e sipërmarrësit e ullirit, folëm për këtë pasuri të çmuar të tokës sonë dhe i sigurova se ekipi i Ministrisë së Bujqësisë do të jetë gjithmonë

pranë tyre për të mbështetur nevojat e sektorit", bëri të ditur Denaj.

Sipas saj, cilësia e mirë e vajit të ullirit "Made in Albania" ka sjellë rritjen e eksporteve të këtij produkti në 5,830 tonë, me 43 herë më shumë në sasi dhe 33 herë më shumë në vlerë gjatë 10-mujorit 2023, krahasuar me një vit më parë.



### SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

### KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

# Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar





# KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



**FED**  
invest 

**GJITHMONË  
FINANCË SOCIALE**




ULLISHTARIA

KONFERENCË KOMBËTARE PËR ULLIRIN DHE CILËSINË E VAJIT TË ULLIRIT

Pandeli Pasko, një emër i njohur i shkencës së agronomisë, prezantoi Certifikimin DOP - treguesi i origjinës së mbrojtur në Vajrat Bimorë

Me një traditë të gjatë në kultivimin e ullirit dhe prodhimit të vajit, vëmendja e re që ka marrë sektori dhe investimet, po e bëjnë gjithmonë e më të prekshëm zgjerimin në tregje të reja. Shqipëria mund të kthehet në një vend konkurrues sa i takon prodhimit dhe eksportit të vajit të ullirit në tregjet ndërkombëtare por për këtë i duhet të konsolidojë markën e saj. Vetëm këtë 8-mujor eksportet kapën vlerën e 25 milionë eurove, me rritje vjetore gati 7 herë më të lartë në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Pikërisht kjo ishte epiqendra e një konference të dedikuar mbi këtë çështje në Expo City, nën titullin "Ulliri dhe Cilësia e Vajit të Ullirit në Shqipëri", ku u diskutua mbi arritjet e eksportit në vitet e fundit, sfidat dhe zgjidhjet e tyre, si dhe objektivat që aktorët kryesorë kanë për këtë produkt. Ministria e Bujqësisë, Anila Denaj bëri thirrje për bashkëpunim të të gjithë aktorëve kryesorë të tregut në mënyrë që të krijohet një ekonomi shkalle që të arrihet rendimenti ekonomik i duhur. Denaj vuri theksin edhe te tregtimi i vajit nën një etiketë dhe jo në format që e shohim sot, pasi ky tregtim ul vlerën e produktit jo vetëm në tregun kombëtar por edhe në atë ndërkombëtar. Ndërsa Eksperti i njohur prof. Pandeli Pasko u ndal në rëndësinë e standardeve të cilësisë që duhet të arrijë prodhimi i vajit të ullirit në vendin tonë, si kriter bazë për nxitjen e eksporteve me vlerë të shtuar.

Logos of Ministry of Foreign Affairs and International Cooperation, AGENZIA ITALIANA PER LA COOPERAZIONE ALLO SVILUPPO, CIHEAM IAMB BARI, and the Albanian coat of arms. Text: PROGRAMI PËR MODERNIZIMIN E BUJQËSISË (PROMAS) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Shqipëri Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I SEKTORIT TË ULLIRIT NË SHQIPËRI Pandeli Pasko CIHEAM Bari Studimi nga P. Pugliese, G. Cardone, S. Madzaric, P. Pasko e Dh. Panajoti http://www.iamb.ciheam.org/



Në periudhën 2017-18 u krye një studim strukturor në terren me pyetësorë dhe analizë SWOT (Projekti ASDO). Shqip - për ne, Anglisht - për dhuruesit (BE). SYNIMI: mbështetje për strategji të qëndrueshme për ullirin dhe vajin e ullirit dhe këshillime thelbësore për zhvillimin e ardhëm.

- PRODHIMI DHE PËRPUNIMI (ASPEKTET TEKNIKE DHE MJEDISORE)
  - ZHVILLIMI I TREGUT (ASPEKTET TREGTARE)
  - LEGJISLACIONI, CERTIFIKIMI DHE POLITIKAT (MBËSHTETJA ADMINISTRATIVE DHE ZHVILLIMORE)
  - PUNA KËRKIMORE, ARSIMI, TRAJNIMI DHE SHËRBIMI KËSHILLIMOR (UNIVERSITETI, TRAJNIMI, KËSHILLIMI, MBËSHTETJA FINANCIARE, ETJ.)
- VËSHTRIM STRUKTUROR (PYETËSORI) KOMPONENTI I DYTË I STUDIMIT, VËSHTRIMI STRUKTUROR, U KRYE NË LIDHJEFUNKSIONALE ME FAZËN E BALLAFAQIMIT TË ANALIZËS SWOT. NJË PYETËSOR I STRUKTURUAR, I HARTUAR DHE DISKUTUAR MË PARË ME EKSPERTËT LOKALË, U PLOTËSUA NGA TË NJËJTËT PUNONJËS (PRODHUES FIDANASH, PRODHUES DHE PËRPUNUES VAJI) TË PËRFSHIRË NË TRYEZAT E PUNËS RAJONALE SWOT.

Paketa e përgjithshme u shoqërua me një UDHËZUES PËR PRAKTIKAT E MIRA me 3 video dhe 500 slide (2019). FIDANISHTET DHE CERTIFIKIMI - patogjenët karantinorë (Xylella fastidiosa) TEKNOLOGJI PRODHIMI - Mbrojtja e integruar Bio - Kulturarët autoktonë - rruga e cilësisë VIDEO - Krasitja dhe mbrojtja nga 'Syri i Palloit' HIGJIENA E PRODHIMIT TË VAJIT - cilësia - siguria ushqimore, HACCP, gjurmueshmëria - , ruajtja - nënproduktet VIDEO - Përdorimi i ujërave të vegjetacionit nga fabrikat e vajit PANEL TESTI - Klasifikimi i vajrave - Vlerësimi - Difektet - Certifikimi DOP

Vështrim i përgjithshëm i analizës SWOT - prodhimi dhe përpunimi

Anët e Forta	Pikë	Dobësi	Pikë
Prania e fabrikave të vajit që kanë arritur standarde cilësie të lartë, duke fituar çmime kombëtare dhe ndërkombëtare	7.8	Mekanizimi i kufizuar dhe menaxhimi i dobët i ullishteve tradicionale	8.6
Rritje e mirë dhe progresive e bazës së prodhimit primar lidhur me mbjelljet e reja, të financuara nga Qeveria Shqiptare në periudhën 2007-2013	7.5	Periodicitet i madh i prodhimit gjatë viteve	8.4
Kapaciteti ekzistues i përpunimit i fabrikave të vajit moderne mund të përpunojë një prodhim shumë më të madh pa kërkuar investime shtesë	7.4	Ndërgjegjësim shumë i ulët i prodhuesve për avantazhet e fidanëve të ullirit të certifikuar	8.4
Përhapje e kullivimit të të paktën dy varieteteve vendase me potencial shumë të mirë tregtar (Kokërmadhi i Beratit dhe Kalinjo)	7.3	Braktisja e ullishteve përgjatë bregdetit	8.3
Mosha e re e prodhuesve të ullirit dhe e përpunuesve (kapitali njerëzor)	7.1	Fragmentimi i madh i tokës dhe shumë ferma të vogla (fermat janë ende shumë të fragmentuara dhe të vogla për të qenë efektive për të pasur produktivitet dhe rentabilitet të mirë)	8.2
Mundësi	Pikë	Rreziqe	Pikë
Forcimi i marëdhënieve teknike me prodhues italianë dhe nga BE dhe me fabrika vaji për teknologji të rinovuara	8.4	Mungesa e kapitalit investues në agrobiznes dhe mungesa e kredisë	8.6
		Rreziku i problematikave të reja fitosanitare	8.0

"KËNDI I POEZISË SË BLERTË"

Gazeta "Agrobiznesi", duke nisur nga ky numër botimi, ka hapur një rubrikë të re nën logon "Këndi i poezisë së blertë".

Kjo rubrikë vjen e ideuar nga profesori i njohur, Enver Isufi, pasioni dhe lidhja e të cilit me bujqësinë, prevalon në çdo drejtim duke përfshirë edhe poezinë.

Enver Isufi, profesori i nderuar, një nga emrat më të njohur të ekspertëve që kontribuon fort, veçanërisht në zhvillimin e bujqësisë organike në Shqipëri, ka botuar një libër me mbi 300 poezi, shumë nga të cilat bazohen tek natyra, mjedisi, prodhimi, biodiversiteti, që i shkojnë përshtat gazetës "Agrobiznesi".

Me autor Enver Isufin, në disa numra të gazetës Agrobiznesi, nën "Këndin e poezisë së blertë", do të botohen 2-3 vjersha dhe një përshkrim i shkurtër i një personaliteti të bujqësisë.

"Këndi i poezisë së blertë", do të jetë një ftesë e hapur edhe për shumë aktorë të linjës, gazetarë dhe ekspertë që merren me bujqësi dhe kontribuojnë në zhvillimin rural, por që puna e tyre e vyer i inspiron për të shkruar për bujqësinë edhe në zhanrin letrar siç është poezia apo proza.

Dëshirojmë që "Këndi i poezisë së blertë", të jetë një vlerë e shtuar në misionin e gazetës "Agrobiznesi", teksa "Poezia është kur emocioni ka gjetur mendimin dhe mendimi ka gjetur fjalët"

Personalitetet e Bujqësisë

MENTOR PËRMETI


(Gjendetist i bimëve bujqësore, ish rektori i Universitetit Bujqësisë, Kamëz, Tiranë)

Gjenerata me agronomë, veterinerë Zooteknikë, dhe inxhinierë të pyjeve E kanë në mendje dhe në zemër Profesor Mentor Përmetin, Yllin e Yjeve. I madh ishte në fushat eksperimentale si gjendetist i bimëve bujqësore I madh ishte si lektor nëpër auditore I madh ishte si shkencëtar deri në akademik. I madh fizikisht, i pashëm, simpatik Kjo vjershë është shumë e vogël, Rektorin tonë për ta përshkruar Kjo vjershë është vetëm një qiri për ta kujtuar.

Nëse mijëra bujq e specialistë rreth portretit dhe bustit të tij Do të ndiznin nga një qiri Do bëhej një dritë e madhe Udhërrëfyese për brezat e rinj.

LUTJA E TOKËS

Mua mund të më lini pa punuar mund të më lini me shkurra e ferra Mbi mua mund të kullosin dele, lopë e derra Nëse keni me bollëk bukë e gjellë Mundet të më lini pa mbjellë Nuk ndjej asgjë, as kur jam nën vapë as kur jam nën brymë Uji i tepërt më mbyll hundët dhe më lë pa frymë Bujku im i dashur për të më kulluar, të lutem bëj përpjekje! Mos më lë në koma! Mos më ço në vdekje!



INFRASTRUKTURA RRUGORE DHE BUJQËSIA

Infrastruktura rrugore po bëhet e shpejtë dhe e mirë. I përshkon kodrat dhe fushat krejt si një zinxhirë. Majtas dhe djathtas, Ka tokë të braktisur, I bie vlera e një zinxhiri të bukur, Mbi një xhakëtë të grisur, E dimë që bujqësia ime Dikur ke prodhuar nën urdhëra e komandë, Por nga majat e kodrave, Fushat dukeshin si në Hollandë.

REFORMAT

Reformat janë si syzet optike Numri i madh të shqetëson Me numrin e vogël nuk shikon Nuk blihen syzet optika pa u vizituar Nuk zbatohen reformat pa i studiuar

KONFERENCË KOMBËTARE PËR ULLIRIN DHE CILËSINË E VAJIT TË ULLIRIT

(Vijon nga faqja 11)

Table with 4 columns: Anët e Forta, Pikë, Dobësi, Pikë. Rows include 'Prirje pozitive të kërkesave për vaj ulliri dhe ullinj për ngrënie' (8.9), 'Shtimi në Shqipëri i njerëzve nga një klasë e mesme e vëmendshme ndaj cilësisë dhe origjinës së produkteve' (7.9), 'Po përdoren sisteme të gjurmueshmërisë (por duhet të harmonizohen me standardet e BE)' (7.2), 'Prania e marëdhëniesve premtuese tregtare për eksport (lidhje të veçanta me komunitetet shqiptare në botë)' (6.6), 'Mundësi' (8.6), 'Tendencat e rritjes së popullsisë së qyteteve dhe e turizmit mund të rrisë mundësitë për rritjen e tregut të vajit të ullirit' (8.1), 'Kërkesa për eksport të produkteve tipike (nga kultivarët e vendit) me cilësi të lartë' (7.4).

Table with 4 columns: Anët e Forta, Pikë, Dobësi, Pikë. Rows include 'Prania e një sektori studimor shkencor të fortë në fushën e ullirit dhe vajit të ullirit' (7.9), 'Sistemi i shërbimeve dhe hallkat e furnizimit ende të dobët në të gjitha nivelet: kërkesa të pakta nga operatorët dhe plotësim i kufizuar e jo profesional i tyre' (8.0), 'Sistemi i shërbimeve dhe hallkat e furnizimit ende të dobët në të gjitha nivelet: kërkesa të pakta nga operatorët dhe plotësim i kufizuar e jo profesional i tyre' (7.6), 'Mundësi' (Pikë), 'Rreziqe' (Pikë), 'Kërkimi shkencor dhe qendrat arësimore shqiptare të përfshira në rrjete ndërkombëtare' (7.7), 'Fonde të kufizuara për kërkime shkencore, për arësimim dhe trajnime' (8.3), 'Kudri ligjor kombëtare i sektorit të prodhimit biologjik nuk zbatohet ende' (7.3).

Table with 4 columns: Anët e Forta, Pikë, Dobësi, Pikë. Rows include 'Soi Ministria e Bujqësisë po përpunon skema kombëtare për zhvillimin e sektorit të vajit të ullirit' (8.6), 'Infrastrukturat për certifikim cilësor (laboratorë, autoriteti i kontrollit, etj.) janë pak të zhvilluara' (8.4), 'Megjithëse kuadri ligjor bazë dhe sistemi i shërbimeve të hallkave të furnizimit janë gradualisht pak a shumë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, duhet ende shumë punë për aktet nënligjore, për ngritjen e kapaciteteve drejtuese institucionale dhe zbatimin e ligjit' (8.0), 'Kuadri ligjor për standardet e cilësisë ekziston (Ligji 8944/2012), por është i paplotësuar' (7.8), 'Mungon strategjia kombëtare për vajin e ullirit' (7.4), 'Fermierët e vegjël bio nuk financohen për bujqësi bio nga ndihma mbështetëse shtetërore' (7.3), 'Rreziqe' (Pikë), 'Sistemi ligjor zbatues i certifikimit për materialin shumëzues nuk zbatohet me efektshmëri' (8.0), 'Të drejtat e pronësisë mbi tokën janë të pasigurta dhe të dyshimta' (7.9), 'Programet IPARD II\* 2014-2020 të financuara nga BE, të cilat zbatohen veçanërisht Instrumentet e Asistencës Para-pranimit për Zhvillimin Rural janë në zbatim, por nuk përfshijnë sektorin e ullirit' (7.4).

Përpunuesit - 84 operatorë: Berat - 14, Elbasan - 11, Fier - 20, Vlora - 23 dhe Tiranë - 16. Përshkrimi i fabrikës të përpunimit të vajit të ullirit – - vetëm 12% bënin pjesë në ndonjë skemë vullnetare të certifikimit. - Metoda e përpunimit e vazhduar e vajit të ullirit (98%) mbizotëron mbi atë tradicional (me presja) (2%) dhe 99% e tyre ju ofrojnë shërbime palëve të treta. - Makineritë janë mesatarisht 11 vjeçare (nga 6 vjet në Berat, deri 16 vjet në Elbasan), me kapacitet mesatar prej 18.2 ton/ditë (11 ton/ditë në Tiranë, 25 ton/ditë në Vlorë).

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji dhjetor 2023

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Pamja e qiellit gjatë muajit Dhjetor 2023

Më 4 dhjetor - Mërkuri në zgjatimin më të madh lindor. Planeti Mërkuri arrin zgjatjen

pastër, është 91%.

Drita e Diellit

Në dhjetor, gjatësia e ditës gradualisht fillon të zvogëlohet

Parashikimi i motit për muajin dhjetor 2023 në Tiranë (Zona bregdetare)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C, Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. Contains 31 rows of weather data for Tirane.

Parashikimi i motit për dhjetor 2023 në Korçë (Zona e ftohtë)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C, Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. Contains 31 rows of weather data for Korca.

më të madhe lindore prej 21.3 gradë nga Dielli. Kjo është koha më e mirë për të parë Mërkurin pasi ai do të jetë në pikën e tij më të lartë mbi horizont në qiellin e mbrëmjes.

Më 12 dhjetor - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do të ndodhë në orën 00:32 UTC.

Më 13 dhe 14 dhjetor - Shiu meteor i Geminids. Geminids është mbreti i reshjeve të meteorëve. Ai konsiderohet nga shumë si shiu më i mirë në qiej, duke prodhuar deri në 120 meteorë shumëngjyrësh në orë në kulmin e tij.

Më 21 dhe 22 dhjetor - Dushi i meteorëve Ursids. Ursids është një shi i vogël meteorësh që prodhon rreth 5-10 meteorë në orë. Ai prodhohet nga kokrrat e pluhurit të lëna pas nga kometa Tuttle.

Treguesit mesatarë klimatike gjatë muajit dhjetor 2023

Table with columns: Treguesit, Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Dibër, Gjirokastrë. Lists various climate indicators like temperature, precipitation, and wind speed for different locations.

lohet çdo vit nga 17-25 dhjetor. Ai do të arrijë kulmin këtë vit në natën e datës 21 dhe mëngjesin e datës 22 Dhjetor. Hëna gjigande në rritje do të bllokojë shumicën e meteorëve më të dobët këtë vit.

Më 22 dhjetor - Solstici i dhjetorit. Solstici i dhjetorit do të ndodhë në orën 03:21 UTC. Poli i Jugut i tokës do të jetë i anuar drejt Diellit, i cili do të ketë aritur pozicionin e tij më jugor në qiell dhe do të jetë drejtpërdrejt mbi Tropikun e Bricjapit në 23,44 gradë gjerësi jugore.

fazë do të ndodhë në orën 01:33 UTC. Kjo hënë e plotë ishte e njohur nga fiset e hershme vendase amerikane si Hëna e Ftohtë, sepse kjo është koha e vitit kur ajri i ftohtë i dimrit vendoset dhe netët bëhen të gjata dhe të errëta.

Parashikimi i motit për muajin Dhjetor 2023

Dhjetori në Tiranë do të ndikohet nga klima bregdetare mesdhetare. Në Tiranë në dhjetor mund të prisni: pothuajse çdo ditë reshje shiu, kohë pas kohe stuhi, herë pas here mjegull, rrallë borë dhe mot më i freskët.

Kalendari, fazat e hënës dhe shënjat astrologjike për muajin dhjetor 2023

Table with columns: Dt., Dita, Dita e Vitit, Dielli (Lind, Perëndon), Zgjatja e ditës, Hëna (Lind, Perëndon), Fazat e Hënës (Faza, %), Shënjat Astrologjike. Contains 31 rows of lunar and astrological data.

(Stuhi), 4 herë Mjegull, më pak se 1 herë Borë. Tirana në Dhjetor do të përjetojë ditë të freskëta me qiell me vranësira të forta. Zakonisht temperatura do të luhatet rreth 13°C dhe do të ndihet për 11°C dhe era do të jetë fllad i lehtë.

Temperaturat e ulëta ditore do të ulen me 3°C, nga 14°C në 11°C, rrallë duke rënë nën 7°C ose duke kaluar 18°C. Temperaturat e ulëta ditore do të ulen me 3°C, nga 4°C në 1°C, rrallë duke rënë nën -5°C ose duke kaluar 9°C.

shkojnë nga 0° C në 11° C.

Muaji dhjetor në Tiranë do të përjetojë në thelb mbulim të vazhdueshëm me re, ku përqindja e kohës që qielli është me vranësira ose kryesisht vranësira mbetet rreth 53% gjatë gjithë muajit. Mundësia më e lartë për kushte vranësirash ose kryesisht vranësira është 55% më 7 dhjetor.

me rreth 12 minuta. Dita më e shkurtër do të jetë 22 dhjetori që ofron 9 orë e 11 minuta dritë dite, lindja e diellit do të jetë në orën 7:04 e mëngjesit dhe perëndimi i diellit do të jetë në orën 16:15 dhe dita më e gjatë do të jetë 1 dhjetori me 9 orë e 26 minuta ditë, lindja e diellit do të jetë në orën 6:48 e mëngjesit dhe perëndimi i diellit do të jetë në orën 16:14. Për një udhëtar, numri i orëve të diellit është shumë i rëndësishëm. Ky muaj do të ofrojë mesatarisht 9 orë dite.





Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe  
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,  
BËHET!*



 **CREDINS bank**

[www.bankacredins.com](http://www.bankacredins.com)

Tel.: +355 4 53 53 000

